

prokop  
dheri

BIBLIOTEKA  
811-1  
06 44

DEKORI  
I  
JETËS  
SIME  
V. ERSHA



85H-1  
8444

**Prokop Dheri**

**DEKORI**

**I**

**JETËS**

**SIME**

*V jersha*

15030

Redaktor: **FATOS GJIKA**

Piktor: **AGRON POLOVINA**

Recenzent: **G. ARIANITI**

SHBP «JV» BERAT

## DJALOSHI VALLTAR

Me pallton mbi supe, këmishë me frak  
Me kravatën e hollë kostum elegant  
Me shkëlqim si ylli, këpuçet me lak  
I hedh sytë te vajza, me buzën në gaz

Ka veshur një të kaltër fustan  
Dhe këpuçët ilustrafinë të vjetra  
I pikon në zemër një lot i acart  
Jetë e lodhur e kapur në kthetra.

Me gulm e me mall e sheh  
E mjera aspak s'i jep shenjë,  
Askush sytë e saj nuk i fsheh  
Rënkton e hesht me aq ndjenjë.

Nella Ellyn atë e quajnë  
Të gjithë e njohin ballkonin e saj  
Dhe Xhoxhi djalë nuk e beson  
Që sytë i ka si lëndinëza në maj.

Dhe erdhi mbrëmjes në mal  
Për të vallëzuar një jetë të tërë  
Gjellat i thoshnin, emër i larë  
Në sy mjegull i kishte rënë.

Ushtonte mali emrin e tij  
Dhe vajza qeshte e qeshte me zjarr  
Ai i hapi krahët në hapësirë  
Dhe e puthi në buzët ngjyrëall.

## INTIMITET

Kokë më kokë të ulur të dy  
Flasim e flasim e s'pushojmë dot  
Shihemi e s'ngopemi sy më sy  
Dalligët e mendimit përplasim fort

Gishtakapur bredhim lart e poshtë  
Fytyrëqeshur nga yni diell  
Jemi gati të pushtojmë sa e sa botë  
Paçka në është dimër a pranverë.

Në sytë tanë ç'pafundësi  
Zemrat tona flatra kanë marrë  
Notojmë të dy në det me dashuri  
Mos qoftë e thënë që të jemi larg!

## FQINJËT

Të vegjël qcnë e luanin të dy  
Këndonin shpesh në oborr  
Dhe thurnin vjersha me sy  
Dhe shkonin shpesh në mal.

U rritën bashkë të dy  
Dhe ecnin kapur për dorë  
Dhe qeshnin me lotë në sy  
Shpesh flisnin me një gojë.

U rritën mënat e qershitë  
U rritën dhe fqinjët të dy  
Siskat e saj u poqën një ditë  
Atij iu shfaqën xixa në sy.

Ikën dimrat, ikën verat  
Fqinjët gjithnjë ishin aty,  
Po fjala e tyre s'doli nga zemrat  
Dhe ata u ndanë të dy.

## L E T Ë R

Mjegulla më fsheh rrugën  
Era horizontin më zbulon  
Shiu i ftohtë më hedh gunën  
- Letra ime drejt teje po shkon.

Larg, larg më je ti  
Dhe letra ime për aty vrapon  
Urimin tim ka marrë në gji  
Dhe si pëllumb fluturon.

Frymën e ka ndalur bora  
Era flokët me vrull m'i kreh  
Të shoh dhe ty me faqet si molla  
Te shkallët e tua letrën e pret.

Këngën time kam shkruar për ty  
Burimi i mallit gurgullon në gji  
Dielli i heshtur më vështon në sy  
I përgjërohem Jetës me dashuri.

## B A R E S H A

Bareshë e vogël moj syshkëndi,  
Gushë pëllumbeshë trupin selvi,  
Façet trëndafil sytë korb të zi,  
Gjinjtë si ftonj, baresha ime ti.

Bareshë trime moj syvetëtimë,  
Vetulla laskonjë fytyra perrì,  
Buzët e kuçç fjalët burim  
Dhembët e bardhë goja si kuti.

Ah, ç'm'u dogj zemra për ty  
Baresha ime që në stan më rri  
Gurgullon në deje gjaku im  
Veç ti bareshë më dhë dashuri.

Fyelli yt bie papushim  
Kënga i ngrë lisat përpjetë  
Zogjtë e pyllit dëgjojnë madhështinë  
Ndërsa delet të qëndrojnë përreth...



## NUSE XANXARE

Një nuse xanxare hipur mbi kalë  
I mori me vete ditënetët si erë,  
Dhëndrri nga pas ecte ngadalë  
Koha kish ngulur dhëmbët në brez.

Nuse e rreptë e bukur si ajo  
Pa betim e fjalë dashurie,  
Bukuria e saj pikte ngado  
Dhe pse nuse pa tel nusërie.

E kujtoj me mall nusen xanxare  
Me fjalën e hollë si një teh  
Të butë nganjëherë si manare  
Tek vallëzonte flutur në erë.

Nuk qeshnin dot burrat me të  
Të holla qenë buzët e saj,  
Ia hidhte botës sytë e mëdhenj  
Dhe tallej lozonjarja me ta...

## EJANI TEK UNË

O ju bukuri të rralla e të shenjtë  
Ju brigje të mbushur me përralla  
Ju virtyte si ujra të kthjellta;  
Ejani tek unë më shtypni kokallat.

O ju shenjtëri bukurimëdha,  
Ju lisa të gjatë që botën shikoni,  
Ju vese si plagë të nëmura;  
Ejani tek unë dashurinë zbuloni!

O ti shpirt i lehtë si era  
Ti dashuri që më lind në pranverë  
Ti maj me lendenëzat e diellit;  
Ejani tek unë ashtu si përherë!

## PËRTEJ VISEVE TË MIA

Larg, përtej viseve të mia  
Është një vend, një ultësirë  
Atje s'ka vlerë trimëria  
Atje tres unë një dëshirë.

Larg, përtej viseve të mia  
Është një vend me pllaja-male  
Atje s'ka vlerë dashuria  
Atje ulem mbi pirgjet-halle.

Larg, përtej viseve të mia  
Është një vend, një lumë i madh  
Atje s'ka vlerë burrëria  
Atje putha veç një imazh.

Larg, përtej viseve të mia  
Është një vend me pyje të rrallë  
Atje u tret dhe humb lumturia  
Atje dheu im më duket mjaltë.

## AJRI QË THITHIM ÇDO ÇAST

S'ka si ajri i malit  
Në ditë me diell a me shi,  
S'ka si zjarri i djalit  
Që ka rënë në dashuri.

S'ka si ajri i fushës  
Në ditë prilli apo maji,  
S'ka si e puthura e gushës  
Që të shenjtëron altari.

S'ka si ajri i lumës  
Në ditë ere apo me re,  
S'ka si e qeshura e çupës  
Kur të thot' shpirt e zemër jê!

S'ka si ajri i detit  
Në ditë të qet' a me futrunë,  
S'ka si fryma e shenjtit  
Që të jep jetë e të jep punë!...

## TE MALI

Vraponi o burra te mali  
Ku folenë Veriu e ka  
Lart o lart me hapa tufani  
Perëndis' t'i them një fjalë.  
Te mali, te mali o trima  
Ku gjendet gjahu dhe stralli  
Atje ku puthet vetëtima  
Më buzë zhuritur prej djali.

Te mali, vraponi o djemë  
Të kapni për dore rrufetë  
Ta puthni me sy diellë  
Atje të përkëdhelni retë.

## PEJSAZH DIMRI

S'po bie më borë përsëri  
Si dikur me erë të ftohtë  
Strehët me kallkan s'janë tani,  
Megjithse dimri është në sofër.  
Strehët pikojnë e pikojnë dashuri  
Vijnë këtu të pyllit rënkime  
Retë janë ulur poshtë plot mërzi  
Dimri harkon një vetull vetëtime.

Ngruhja e ftohtë hesht me magji  
Strehët vajtojnë me lotë  
E ftohta hedh gunën nëpër shi  
Ti më vjen me zemër të ngruhtë.  
Ja nisi dëbora me urtësi  
Si plak i moçëm nga koha  
Flokë-flokë bie si përjetësi  
Veç zemrën time s'e prek lloha.

## D È B O R A

Si fluturza të bardha maji  
Si kristale në një zemër vajze  
Si ëndërr e mëngjesit të bardhë,  
Ashtu bie bora e parë.

E hollon qiellin si brisk  
Vello nusërie hedh ngado  
Gjithë shpirtrat i mbush ric  
Drejt zemrash rend dhe dò!

Misteri yt borë e bardhë  
Misteri i rrafshit Qiell e Tokë  
Misteri i një valleje ngadalë  
Misteri i një zemre të bërë copë.

Dashuria jote është psherëtimë  
Fjalëzat e tua si burim mali  
Ngrohtësia jote një ledhatim  
Siç bie në gjirin e vajzës djali.

...Sytë m'i vret bardhësia jote  
Sytë m'i lbyr kjo madhështi,  
Hesht dhe shkruaj si në ato mote  
Kur isha djalë, po djalë i ri.

## NUK DI T'KËNDOJ

Unë nuk di  
Nuk di të këndoj,  
Vendin tim e dashuroj.  
Unë nuk di  
Nuk di veçsë  
Emrin e shenjtë Atdhè!

Unë nuk di  
Nuk di të këndoj  
Këtë vend e dashuroj;  
Kur kam lojtur  
Në avlli  
Vend i bukur Shqipëri!

Unë nuk di  
Nuk di t'këndoj  
Vatrën time e dashuroj;  
Ku kam lindur ku kam lè  
Aty ku vetë Shenjti flè  
Asht i shtrenjti Mëmëdhè!

## FLETËT BIEN

Bien fletët një nga një  
Siç bie shpesh e malit borë  
Tapët i verdhë i vjeshtës rënë  
Në gjoks zemra ime gufon.

Bien fletët e vëlura nga jeta  
Jetëshkurtrat si ato  
Bien dhe japin shpirtserrat  
Ca rënkime si mal me bor'.

Bien fletët dhe psherëtinjë  
Si urë e hallit në ditë me shi  
Shtroia e tyre zemërflorinjte  
Mbush me djersë dhe trimëri.



## FYTYRA E DYTË

Sa të pashë më buzëqeshe  
Dhe ajo t'u tret ngadalë  
Në prapaskenë qe ngërdheshje  
Nëpër kuinta dhemb i bardhë.

Të pashë e ti me përzemërsi  
Më puthe fort më leve jargë  
Nëpër arie end me ligësi  
Një dëshirë e fjalë si bajgë.

Pashë një fytyrë të dytë  
Engjëll-djall, vend që nxë  
Dhe ika i tmerruar nga sytë  
Mos ma ngjiste dhe mua atë!

Sa të pashë më buzëqeshe  
Pas perdes së saj endej ngadalë  
Tis i hollë i një përqeshjeje,  
Nëpër zemër vdekje e gjallë!...

## M E D I T I M

Qie!l i kaltër pa kufi  
Mua më përpi  
Qie!l i kaltër e krenar  
Në zemrën time po të marr.

Kurorë ylberi, kurorë me lule,  
Erë xanxare, fytyrë engjëllore,  
Rrugë me njerëz përpara sulen  
Të vijnë tek ti o qie!l pròre.

Ja e shoh një lule të bukur  
Veç nga të tjerat fluturon,  
Një shpirt është si një flutur  
Drejt, me guxim, në parajs' shkon.

## E VËRTETË

Asht çasti i tubimit tek e vërteta  
T'i besojmë fëmijës se ata janë Jeta,  
Mjaft urrejtje dhe grindje të tjera  
Erdhi koha për Rilindjen - E mjera!

Sa gazmend kam te ky popull  
Kur zemrat së bashku rreth e rrotull  
Kemi një At edhe një Mëmë  
Kur i gjithë Dheu mburret me tënë!  
Ne jemi pranë me këtë vend

Kur qemë të rinj e tash pleq me mend,  
Të bashkojmë pra shpirt e zemër thjeshtë  
Dhe o burra të mbetemi bashkë për Jetë!

EMILIO

530517

## S A B Ë R

Sàbër, sàbër të dhëntë Zoti:

○ Njeri fatkeq në jetë

○ ti që zemrën ta mbushën me vrer

○ ti që vajton e dot s'hesht.

Sàbër, sàbër të dhëntë Zoti:

○ Njeri që në vetëdije bluan

○ ti që të mira në shpirt gatuan

○ ti që durimin e ke bërë zakon.

Sàbër, sàbër të dhëntë Zoti:

○ Njeri që veç ndihmë jep

○ ti që kurrë për vete s'merr

○ ti që dhimbjen pas nuk e kthen.

Sàbër, sàbër të dhëntë Zoti:

○ Njeri që bukën e gojës e ndan

○ ti që forcën të gjallë e mban

○ ti që dhe birin e përcjell në varr.

## L O T I

Lot i nxhtë që më gërryen në faqe  
Lot i ftohtë që më ngrin në sy  
Eja e më sill një manushaqe  
Dhe unë të t'i kthej në dy.

Lot gërryes që buron nga zemra  
Lot përvëluc që buron nga dhimbja  
lot i heshtur që më rri te kënga  
Lot i kaltër që gurgullon te retina.

Lot që sytë m'i mban gjallë  
Lot që m'i shfaq lëndinëzat në maj  
Lot që ma bën zemrën të rrallë  
Lot që më sjell dhe dimër – acar.

Lot i kthjellët i një zemre vashe  
Lot i trishtë i një zemre nëne  
Lot i padurueshëm dhe pa naze  
Lot që m'i jep jetë kësaj kënge.

## DEKOR I JETËS SIME

I njëjti dekor nuk ka qenë jo,  
Të njëjtin dekor s'e kam dashur kurrë,  
Dekor në jetë bëhet ajo që do  
Dekor i bukur po dhe absurd.

Malet qenë dekori im i parë  
Diellin që lindte mu në agim  
Lumin që sillte ujin me mall  
Njerzit që vinin e iknin me nxitim.

Fushat qenë dekori im i dytë  
Hëna e përndritur për dashuri  
Dhe pas më kanë ndjekur veç sytë  
Sytë më kanë dhënë lumturi.

I njëjti dekor s'më ka pëlqyer  
Të njëjtin dekor nuk e dua më  
Ashtu si nuk i shkel të njëjtat dyer,  
Veç kur jam këtu në tokën mëmë.

## URREJTJEN NUK Ë DUA

Unë nuk urrej njeri kurrë!  
Urrej veç gjërat e liga tek ai,  
Urrejtja buron kështu tek unë,  
Gjithnjë nga e larta dashuri.

Unë nuk urrej dot askënd!  
As malet, as lumin, as detin e gjerë,  
As ajrin jetëdhënës të shpirtit tënd,  
As motin e keq që më mbush me vrerë

Unë nuk urrej se jam njeri!  
Urrej veç ato që s'më pëlqejnë tek ti  
Urrejtja është ves këtë mirë e di  
Dhe në politikë është zi e më zi.

Urrejtjen jo kurrë nuk e dua  
Urrejtja plagët në trup m'i shton  
Urrejtja jetën dhe shpirtin ma truan z z  
Urrejtja dhe këtë këngë ma vdekëson!...

## F A T I

Fati më thotë përditë mirëmëngjes  
Fati ka fjetur gjithë natën me mua  
Fati çdo çast më buzëqesh  
Fati kur do nuk më ruan.

Fati është qelq e thyhet  
Fati është bisedar me yjet  
Fati është lumë dhe fryhet  
Fati është muzg dhe ndryhet.

Fatin aq pranë ne e kemi  
Fatin s'e shohim dot kurrë  
Fati të çon në gjendje jermi  
Fatin e duron kush është burrë.

Ky është fati, themi aq shpesh  
Fati, kështu është shkruar,  
Fati në fund të dheut ngjesh  
Po edhe vetë fati vuan!

Fati është britmë lemerie  
Fati është dhe i vdekjes korb  
Fati është çast dashurie  
Fati na lidh e na bën të fortë!

## NJËLLOJSHMËRI

Hije monotone që bredh nëpër botë  
Ngjyrë gri e padurueshme ti je  
I puth të gjitha pa horizont  
Lakun jetës përditë ia ngrë.

Njëllojshmëri të tmerrshme nuk dua  
As kur ha me miq e me shokë  
As kur fle gjithnjë me një grua  
As ku bisdat më hedhin për tokë.

Monotoni e zbrazët ty të urrej  
Ti më mban frymën e të madhit Zot  
Ti më shtyn çdo çast të gënjej  
Ti që dashurin' ma zhduk nga kjo botë!

Hije monotone ka brenda njeriu  
Rë mërzie që shfaqen gjithmonë  
Veç kur fryn Jugu a Veriu  
Monotonia na mbetet pa Fron...



## PERMBAJTJA

Djaloshi valltar .. . . . .	.. . . . .
Intimitet .. . . . .	.. . . . .
Fqinjët .. . . . .	.. . . . .
Letër .. . . . .	.. . . . .
Baresha .. . . . .	.. . . . .
Nuse xanaxare .. . . . .	.. . . . .
Ejaní tek unë .. . . . .	.. . . . .
Përtej viseve të mia .. . . . .	.. . . . .
Ajri që thithim çdo çast .. . . . .	.. . . . .
Te mali .. . . . .	.. . . . .
Pejsazh dimri .. . . . .	.. . . . .
Dëbora .. . . . .	.. . . . .
Nuk di t'këndoj .. . . . .	.. . . . .
Fletët bien .. . . . .	.. . . . .
Fytyra e dytë .. . . . .	.. . . . .
Meditim .. . . . .	.. . . . .
E vërtetë .. . . . .	.. . . . .
Sabër .. . . . .	.. . . . .
Loti .. . . . .	.. . . . .
Dekor i jetës sime .. . . . .	.. . . . .
Urrejtjen nuk e dua .. . . . .	.. . . . .
Fati .. . . . .	.. . . . .
Njëllojshmëri .. . . . .	.. . . . .

20



{



*Prokop Dheri*  
*ka lindur në Berat*  
*dhe në moshën 14 vjeçare*  
*ka mërguar në Bukuresht (Rumani).*  
*Tani ka ardhur në qytetin e lindjes*  
*me një tufë poezish,*  
*ashtu dhe me vepra të tjera.*